



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

---

**R R E G U L L O R E**

**Nr.78 Datë 16. 04. 2010**

**PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT**

**DHE**

**FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR**

*Me synimin*, organizimin e ushtrimit të inspektimit të veprimtarisë së prokurorëve dhe fillimin e procedimit disiplinor;

*Në mbështetje*, të nenit 8 pika 2 germa “gj” e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë ", me ndryshimet e mëvonshme të tij, si dhe të Urdhërit nr.26, datë 06.09.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për strukturën, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm”,  
**caktoj këto rregulla:**

**Neni I**

**Përkufizimi i inspektimit të prokurorit**

Me inspektim të prokurorit do të kuptohet, kontrolli i veprimtarisë së punës së prokurorit, gjatë ushtrimit të ndjekies penale, perfaqesimit të akuzës në gjykim, ekzekutimin e vendimeve penale, të detyrave të tjera të parashikuara me ligj, si dhe sjellja morale etike gjatë kryerjes së funksioneve të tij.

## **Neni 2**

### **Subjekti i ushtrimit të inspektimit**

Inspektimi i veprimtarisë profesionale të prokurorëve të të gjitha organeve të prokurorisë do të realizohet nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore.

## **Neni 3**

### **Parimet bazë të inspektimit në veprimtarinë e prokurorit**

Në ushtrimin e inspektimit mbi veprimtarinë e punës së prokurorit, Drejtoria e Inspektimit dhe e Burimeve Njerëzore, mban në konsideratë dhe respekton parimet e:

- a. Ligjshmërisë.
- b. Pjesëmarrjes së prokurorit në procedurë, nepërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij.
- c. Formalizimit të procedurave.
- d. Ndalimit të ribërjes së një procedure të trajtuar më parë.
- e. Tipizimit të shkeljes dhe propocionalitetit.
- f. Trajtimit të njëjtë dhe të barabartë.

## **Neni 4**

### **Inspektimi i prokurorit**

1. Inspektimi i prokurorit, bëhet me urdhër të motivuar të Prokurorit të Përgjithshëm.

## **Neni 5**

### **Karakteret e inspektimit të prokurorit**

1. Inspektimi i prokurorit mund të ketë karakter njohës së efektivitetit të veprimtarisë ose për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore të tij.

## Neni 6

### Llojet e inspektimit të prokurorit

1. Inspektimi i prokurorit mund të jetë:

a- **Inspektim i përgjithshëm**, i cili zhvillohet mbi bazën e planifikimit vjetor të inspektimeve të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky lloj kontrolli ka si synim, kryerjen e inspektimeve të plota në çdo prokurori jo më pak se një herë në tre vjet dhe përgjithësisht ka karakter njohës, për veprimtarinë e punës që kryhet nga të gjithë prokurorët e sistemit të prokurorisë, për efekte të vlerësimit të aftësive dhe të karrierës profesionale se prokurorit.

b- **Tematik ose i pjesshëm**, që zhvillohet në bazë të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm, për grup veprash penale apo për procedimeve penale të veçantë, të cilat konstatohen problematike në zbatimin e ligjit penal e procedural apo urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ky lloj inspektimi, urdhërohet duke marrë shkas nga:

-Verifikime të ankesave të ndryshme rezultojnë se prokurori, zbaton në mënyrë të gabuar ligjin penal e procedural apo urdhërat e udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm. Verifikimi i ankeses/ve mund të bëhet nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore apo nga Drejtori të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme;

-Informacione të drejtuara Prokurorit të Përgjithshëm, nga drejtori të ndryshme pranë Prokurorisë së Përgjithshme, apo nga drejtues të prokurorive në shkallë të parë apo në apele, me anë të të cilëve për prokuror të caktuar paraqiten shkelje disiplinore konkrete në veprimtarinë e punës së tij hetimore apo gjyqësore;

-Informacione apo të dhëna të tjera konfidenciale të drejtuara Prokurorit të Përgjithshëm, nga subjekte të ndryshme shtetëror, nga të cilat dalin të dhëna që vënë në dyshim zbatimin me korektesë të kërkesave të ligjore nga prokurori;

-Të dhënat statistikore të treguesve të punës në nivel prokurorie, të administruara nga Sektori i Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga studimi i rezultateve e të dhënave statistikore, mund të diktohen nevoja për inspektime, në lidhje me politikën e goditjes së krimit për vepra penale që rezultojnë në rritje për një moment të caktuar, në lidhje me kushtet dhe kriteret e zbatimit të masave të sigurimit ndaj të dyshuarve të veprave penale etj.

c- **Verifikues**, i cili merr në shqyrtim rekomandimet dhe sugjerimet e inspektimeve të kryera nga Ministria e Drejtësisë, për prokuror dhe prokurori të ndryshme në shkallë vendi. Inspektimi në këto raste, kryhet nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, duke marrë në shqyrtim procedimet penale të përmendura në raport kontrollin

e Ministrisë së Drejtësisë, sugjerimet e rekomandimet e trajtuara dhe observacionet e prokurorëve të rezultuar me shkelje.

## **Neni 7**

### **Verifikimi i ankesave në veprimtarinë e prokurorit**

1. Verifikimi i ankesës/ave është procesi i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve, për fakte dhe rrethana që lidhen me veprimtarinë e prokurorit dhe që realizohet nepërmjet administrimit, analizës e ballafaqimit të të dhënave konkrete.

2. Verifikimi i mund të kryhet edhe për ankesë/a që lidhen me qendrimin etiko-moral të prokurorit. Në përfundim të kryerjes së verifikimeve, me rezultatin e tij, vihet në dijeni prokurori ndaj të cilit ishte drejtuar ankesa dhe i interesuari.

## **Neni 8**

### **Shkaqet e inspektimit të prokurorit dhe afatet**

1. Inspektimi i prokurorit me karakter njohës së veprimtarisë së tij bëhet me urdhër të motivuar të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi bazën e një kalendari paraprak pune të shqyrtuar nga Këshilli i Prokurorisë, që brenda një periudhe 3-vjecare të inspektohen të gjithë prokurorët e prokurorive të shkallës së parë dhe të prokurorive të apelit.

2. Inspektimi i prokurorit për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore të tij urdhërohet nga Prokurori i Përgjithshëm, kur:

a. Nga verifikimi i ankesës\ave, është arritur në përfundim se prokurori ka lejuar ose kryer shkelje apo mosrespektim të dukshëm të ligjit, ç'ka ngre dyshime për një mënyrë sjelljeje problematike në raport me zbatimin e ligjit.

b. Nga të dhënat e raport kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë, konstatohet se, prokurori ka kryer shkelje, mosrespektim të ligjit apo urdhrave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

c. Në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale prokurori rezulton i "paaftë". Në këtë rast inspektimi i prokurorit është i detyrueshëm.

## Neni 9

### Procedura e inspektimit

1. Inspektimi kryhet bazuar në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm, ku përcaktohet lloji i inspektimit, prokurori/ët që inspektohen, periudha kohore që i nënshtrohet kontrollit, afati i përfundimit të inspektimit dhe prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të ngarkuar për kryerjen kryerjen e tij.
2. Kryerja e inspektimit të përgjithshëm të veprimtarisë së prokurorit\ve, kur kontrolli ushtrohet me grup prokurorësh të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, ndarja e prokurorëve që do të kontrollohen bëhet me short. Hedhja e shortit dokumentohet me procesverbal.
3. Në çdo rast, prokurori/ët që ushtrojnë kontrollin duhet të informojnë paraprakisht drejtuesit e prokurorisë, të paktën me tre ditë përpara duke përjashtuar rrethana urgjente, si dhe prokurorin/ët që inspektohen me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm për ushtrimin e inspektimit.
4. Kryerja e inspektimit bëhet brenda afateve të përcaktuara në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm. Me kërkesë të prokurorit/ve që ushtrojnë kontrollin, afati i përcaktuar mund të shtyhet për shkaqe të arsyeshme.
5. Në përfundim të inspektimit, para përpilimit të raportit përfundimtar, prokurori/ët që kryejnë inspektimin, për problemet që kanë nevojë për sqarime, diskutojnë dhe marrin informacion nga prokurori ose drejtuesi i prokurorisë.
6. Raporti përfundimtar dërgohet me shkresë në prokurorinë përkatëse. Drejtuesi i Prokurorisë, duhet të marrë masa të menjëhershme për të njohur prokurorët me raportin e kontrollit. Procedura e njohjes duhet të dokumentohet me deftese komunikimi për çdo prokuror.
7. Prokurori i inspektuar ka të drejtë të paraqesë më shkrim kundërshtimet e tij, për raportin e kontrollit. Këto kundërshtime administrohen nga drejtuesi i prokurorisë i cili brenda 15-ditëve nga data e mbërritjes së raportit të kontrollit në prokurori duhet ti përcjellë me shkresë në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.
8. Prokurori/ët e ngarkuar me ushtrimin e kontrollit pasi njihen me kundërshtimet, kur i gjejnë të bazuara, bëjnë ndryshimet e nevojshme në raportin e kontrollit.
9. Mosparaqitja e kundërshtimeve nga prokurori i inspektuar, nuk pengon prokurorin/ët e ngarkuar me ushtrimin e kontrollit, për të bërë sugjerimet e tyre, kur vlerësohet se ka vend për fillimim e procedimit disiplinor.

## **Neni 10**

### **Llojet e raporteve të inspektimit**

Llojet e raporteve të inspektimeve janë, raporti inspektimi individual dhe raporti I inspekitimit të përgjithshëm;

1. Raporti i inspektimit individual, përpilohet për veprimtarinë e prokurorit dhe qëndrimin e tij etiko-moral, gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit të akuzës në gjykim, ekzekutimit të vendimeve penale dhe të detyrave të tjera të parashikuar me ligj. Raport inspektimi individual përpilohet edhe për drejtuesin e prokurorisë dhe zëvendësit e tij.
2. Raporti i inspektimit të përgjithshëm përmban të dhëna për volumin, shpejtësinë, cilësinë dhe problematikën e konstatuar nga kontrolli i kryer.

## **Neni 11**

### **Përmbajtja e raportit të inspektimit**

1. Raportet e Inspektimit formulohen me shkrim dhe, si rregull, duhet të përmbajnë:
  - a. Të dhëna statistikore për ngarkesën e punës së kryer nga prokurori, për periudhën objekt kontrolli.
  - b. Cilësinë për veprimtarinë e prokurorit, gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit të akuzës në gjykim, ekzekutimin e vendimeve penale dhe të detyrave të tjera të parashikuar me ligj.
  - c. Të dhëna të tjera, që lidhen me qëndrimin etiko-moral të prokurorit gjatë kryerjes së detyrës.
  - d. Kur është rasti, vërejtje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së prokurorit.
  - e. Kur konstatohen shkelje të ligjit apo të urdhrave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, bëhet përshkrimi i natyrës dhe vlerësohet rëndësia e tyre.
  - f. Kur është rasti, i propozohet Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e procedimit disiplinor.
  - g. Përshkrimi i punës së prokurorit për sa i takon drejtimit dhe kontrollit të veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe kur është rasti, sugjerimi për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit/agjentit të policisë gjyqësore.
  - h. Praktikën e mira që vihen re në funksionimin e shërbimeve të ndryshme të prokurorisë dhe të prokurorëve, të nxirret në pah për vlerat pozitive të saj në ushtrimin e funksioneve të prokurorit.

2. Raporti i inspektimit të prokurorit bëhet pjesë përbërëse e dosjes së tij personale, që ndodhet në Prokurorinë e Përgjithshme pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore.

## **Neni 12**

### **Mënyra e përfundimit të inspektimit**

1. Në rastet kur nga inspektimi i prokurorit rezulton se, në veprimtarinë e punës së tij, konstatohen arritje dhe tregues cilësorë, pasi bëhet vlerësimi paraprak i aftësive të tij, raporti i kontrollit i bëhet i ditur Prokurorit të Përgjithshëm dhe kalohet për vlerësim në Këshillin e Prokurorisë, për efekte të karrierës profesionale.

2. Nëse nga inspektimi i prokurorit rezulton se, në veprimtarinë e punës së tij, konstatohet se janë kryer shkelje, të natyrës që parashikohen në nenin 32 të ligjit Nr. 8737, datë 12.02.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i sugjerohet Prokurorit të Përgjithshëm fillimi i procedimit disiplinor.

3. Në rast se nga inspektimi i prokurorit rezulton se, në veprimtarinë e tij konstatohen shkelje të rënda të ligjit, i sugjerohet Prokurorit të Përgjithshëm përveç fillimit të procedimit disiplinor edhe pezullimi nga detyra e prokurorit të kontrolluar.

4. Nëse nga inspektimi i prokurorit, nga analiza në tërësi e veprimtarisë së tij, vlerësohet "i paaftë", sipas nenit 42 pika 6 dhe 7 të ligjit Nr. 8737, datë 12.02.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i sugjerohet Prokurorit të Përgjithshëm fillimi i procedimit disiplinor.

## **Neni 13**

### **Fillimi i procedimit disiplinor**

1. Fillimi i procedimit disiplinor për prokurorin/ët urdhërohet nga Prokurori i Përgjithshëm, me vendim të arsyetuar, pasi është njohur me raportin e kontrollit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe kundërshtimet e prokurorit të inspektuar.

2. Procedimi disiplinor fillon kur nga çasti i vënies re të shkeljes/ve nuk kanë kaluar më shumë se tre vjet nga momenti i kryerjes së shkeljes/ve dhe nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj nga momenti i konstatimit të shkeljes.

2.1 Kalimi i çdonjërit prej këtyre dy afateve përcakton shuarjen e përgjegjësisë disiplinore që mund t'i kërkohet prokurorit për shkak të parashkrimit të shkeljes së kryer.

3. Momenti i konstatimit të shkeljes konsiderohet, data e përpilimit të raportit të inspektimit përfundimtar nga prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, në të cilin trajtohet shkelja.

## **Neni 14**

### **Urdhri për fillimin e procedimit disiplinor**

1. Urdhri për fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorit të inspektuar nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm. Në këtë urdhër përshkruhet shkurtimisht natyra e shkeljes/ve për të cilat çmohet se duhet të fillohet procedimi disiplinor.

2. Me njoftimin e urdhrit ngarkohet Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, e cila i komunikon urdhrin prokurorit të proceduar, si dhe ndjek procedurat deri në shqyrtimin e procedimit disiplinor nga Këshilli i Prokurorise.

3. Kur pas fillimit të procedimit disiplinor konstatohen shkelje të tjera të natyrës së parashikuar nga neni 32 të Nr. 8737, datë 12.02.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë ", Prokurori i Përgjithshëm urdhëron plotësimin e objektit të procedimit disiplinor.

4. Prokurorit të proceduar i jepet koha e mjaftueshme sipas ligjit për të realizuar mbrojtjen e tij, për objektin e shtuar.

## **Neni 15**

### **Rregjistri i procedimit disiplinor**

Urdhëri për fillimin e procedimit disiplinor regjistrohet në regjistrin e procedimeve disiplinore i cili mbahet në sekretarinë e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore.



## **Neni 16**

### **Pezullimi i prokurorit të proceduar**

1. Kur gjatë inspektimit të prokurorit në veprimtarinë e tij, konstatohen shkelje të rënda disiplinore, Prokurori i Përgjithshëm, përveç fillimit të procedimit disiplinor, mund të urdhrojë pezullimin e prokurorit të inspektuar, derisa të plotësohet procedura e kërkuar për përgjegjësinë disiplinore, por jo më shumë se 30 ditë.
2. Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerzore brenda kësaj periudhe duhet të pregatisë matrialin për procedimin disiplinor.
3. Me urdhrin e pezullimit për efekt të procedimit disiplinor, prokurorit të proceduar i ndërpriten marrëdhëniet financiare, deri në përfundimin e procedimit disiplinor.
4. Në rastet kur ndaj prokurorit të pezulluar jepet masa e shkarkimit nga detyra, atij nuk i paguhet paga për periudhën e pezulluar.

## **Neni 17**

### **Relacioni për fillimin e procedimit disiplinor dhe përmbajtja e tij**

1. Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerzore, pasi njihet me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në këtë urdhër, përpilon relacionin për fillimin e procedimit disiplinor.
2. Relacioni për fillimin e procedimit disiplinor përmban:
  - a- Të dhëna të detajuara për shkeljet e përmendura në urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor.
  - b- Të dhëna të tjera të cilat janë të administruara në dosjen personale të prokurorit të proceduar që kanë të bëjnë me vlerësimet e mëparshme të tij, me masat disiplinore në ngarkim të tij, n.q.s ka, apo tregues të tjerë që kanë të bëjnë me qëndrimin etiko-moral të prokurorit.

## **Neni 18**

### **Njohja e prokurorit të proceduar me dokumentacionin e procedimit**

1. Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerzore merr masa për t'i dorëzuar prokurorit të proceduar urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor

dhe relacionin përkatës, si dhe i cakton një afat, jo më pak se dhjetë ditë, por jo më shumë se 20 ditë, për të përgatitur mbrojtjen e tij.

2. Dokumentimi i njohjes së prokurorit me aktet e procedimit disiplinor, kryhet nëpërmjet deftesës së komunikimit, në të cilën shënohen data e marrjes në dorëzim të akteve të mësipërme.

3. Prokurori që është pezulluar nga detyra për shkak të fillimit të procedimit disiplinor, është i detyruar të pasqyrojë në deftesën e komunikimit adresën e saktë të banimit të tij. Në rastet e ndryshimit të adresës së banimit, është i detyruar të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore.

## **Neni 19**

### **Njohja e anëtarëve të këshillit të prokurorisë me dokumentacionin e procedimit**

1- Drejtorja e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore vë në dispozicion të çdo anëtari të Këshillit të Prokurorisë një kopje të dokumentacionit për procedimin disiplinor të prokurorit jo më vonë se shtatëdhjetë orë përpara datës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes.

2. Dokumentacioni përbëhet nga urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e procedimit disiplinor, relacioni i detajuar i shkeljeve, dëftesa e komunikimit dhe aktet e mbrojtjes së prokurorit të proceduar, nëse ky i fundit ka paraqitur mbrojtjen e tij.

3. Në rastet kur përveç fillimit të procedimit disiplinor, ndaj prokurorit të proceduar është urdhëruar edhe pezullimi i tij nga detyra e prokurorit, dokumentacionit të mësipërm i shtohet edhe urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e tij nga detyra.

## **Neni 20**

### **Njoftimi i datës së mbledhjes së këshillit të prokurorisë**

Drejtorja e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore njofton prokurorin ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor dhe anëtarët e Këshillit të Prokurorisë për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën shtatëdhjetë orë përpara fillimit të saj.

## **Neni 21**

### **Administrimi i materialit të procedimit disiplinor**

1. Drejtorja e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore administrojnë në dosjen personale të prokurorit të proceduar vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për marrjen e masës disiplinore ose Dekreti i Presidentit të Republikës.

2. Në dosjen personale administrohen kur është rasti edhe vendimi i Gjykatës, kur masa është shqyrtuar ne Gjykatë.

3. Për çdo procedim disiplinor formohet një fashikull i veçantë, i numërtuar sipas numrit respektiv te rregjistrimit te procedime disiplinore.

4. Fashikulli i procedimit disiplinor përmban të gjitha aktet që formohen deri në fund të procedimit disiplinor si; dokumentacioni paraprak që u jepet anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë, kundërshtimet dhe mbrojtia e prokurorit te proceduar, procesverbalet e mbledhjes, kërkesat paraprake të prokurorit të proceduar, vendimet e ndërmjetme të Këshillit të Prokurorisë, aktet apo raportet verifikues të kërkuara nga Këshilli, mendimet e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë për shkeljet apo masën disiplinore, masa disiplinore që vendoset nga Prokurori i Përgjithshëm.

## **Neni 22**

### **Ndërprerja e procedimit disiplinor**

Procedim disiplinor ndërpritet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, në rastet kur;

- a) prokurori i proceduar vdes
- b) kur prokurori i proceduar jep doreheqien dhe doreheqia e tij pranohet nga Prokurori i Përgjithshëm
- c) kur pas fillimit të procedimit konstatohet fakte dhe rrethana që tregojnë se shkelja e proceduar nuk qendrojnë apo për shkaqe dhe rrethana të vlerësuara prej tij.

## **Neni 23**

### **Dispozita kalimtare**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**Ina RAMA**